

VENDIM
Nr.15, datë 25.4.2020

**PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR GARANTIMIN E ZBATIMIT TË
PROTOKOLLEVE TË SIGURISË NË KUADËR TË EPIDEMISË SË SHKAKTUAR
NGA COVID-19**

Në mbështetje të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të aktit normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, me qëllim garantimin e zbatimit të protokolleve të sigurisë në kuadër epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, Komiteti Ndërmënytor i Emergjencave Civile, i mbledhur sot në datën 25.4.2020,

VENDOSI:

1. Krijimin e Task-Forcës, si një strukturë të posaçme të përkohshme, për garantimin e zbatimit të protokolleve të sigurisë në njësitë tregtare të lejuara të ushtrojnë aktivitetin për periudhën e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

2. Task-Forca kryesohet nga Kryeministri dhe në përbërje ka këta anëtarë:

- ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

- ministrin e Brendshëm;

- ministrin e Drejtësisë;

- ministrin e Shtetit për Rindërtimin;

- ministrin e Financave dhe Ekonomisë;

- ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

- ministrin e Turizmit dhe Mjedisit;

- ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Task-Forca ka si mision garantimin e zbatimit të protokolleve të sigurisë në njësitë tregtare të lejuara të ushtrojnë aktivitetin për periudhën e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

4. Pranë Task-Forcës funksionon Njësia Operacionale, e cila drejtohet nga Kabineti i Kryeministrit dhe në përbërje ka përfaqësues nga:

- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;

- Inspektorati i Punës dhe Sigurimeve Shoqërore;

- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut;

- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

5. Njësia Operacionale e Task-Forcës është përgjegjëse për kontrollin në terren për garantimin e zbatimit të protokolleve të sigurisë në njësitë tregtare të lejuara të ushtrojnë aktivitetin për periudhën e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

6. Njësia Operacionale kryen dhe zbaton detyrat e dhëna nga Task-Forca.

7. Njësia Operacionale, në rast konstatimi të shkeljeve të protokolleve të sigurisë në njësitë tregtare të lejuara të ushtrojnë aktivitetin për periudhën e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, i raporton këto shkelje pranë institucioneve kompetente për marrjen e masave përkatëse.

8. Task-Forca ndihmohet nga sekretariati teknik në detyrat administrative. Sekretariat teknik është Instituti i Shëndetit Publik.

9. Njësia Operacionale e Task-Forcës raporton në mënyrë periodike pranë Task-Forcës, si dhe sa herë që i kërkohet prej saj.

10. Periudha e veprimit të Task-Forcës dhe e Njesisë Operacionale do të jenë deri në përfundim të periudhës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

11. Ngarkohen Task-Forca dhe institucionet e përmendura në pikat 2 dhe 4, të këtij vendimi, për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINISTROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama